

VENDIM
Nr. 193, datë 30.8.2018

**MBI MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PLOTË TË LICENCËS SË SHOQËRISË
“OSOJA ENERGY” SHPK, NR. 408, SERIA P18K, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT
NR. 113, DATË 14.5.2018, PËR AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “SEMAN 1”, ME VENDNDODHJE,
SHEQ, MARINAS, FIER, ME FUQI 2 mw, PËR NJË AFAT 20-VJEÇAR DHE KALIMIN
E SAJ TE SHOQËRIA “SEMAN 1 SOLAR” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 10 pika 1; 17, pikat 1 dhe 4; të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi transferimin e licencës nr. 408, seria P18K, të shoqërisë “Osoja Energy” sh.p.k., për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Seman 1”, me vendndodhje Sheq, Marinas, Fier, me fuqi 2 mw dhe kalimin e saj te shoqëria “Seman 1 Solar” sh.p.k.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 174, datë 3.8.2018, filloi procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Osoja Energy” sh.p.k., me nr. 408, seria P18K, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 14.5.2018, për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Seman 1”, me vendndodhje Sheq, Marinas, Topojë, Bashkia Fier, me fuqi të instaluar 2 mw, për një afat 20-vjeçar, te shoqëria “Seman 1 Solar” sh.p.k.

- Në vijim të sa më sipër, ERE me shkresën nr. 55/53 prot., datë 6.8.2018, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 413/3 prot., datë 9.8.2018, i ka kërkuar subjektit për nevoja të vendimmarrjes finale të informohet mbi vullnetin/dakordësinë e subjektit “Seman 1 Solar”, në lidhje me pagesën e kryer gabimisht nga subjekti “Seman 1 Solar” sh.p.k., për transferimin e licencës nga “Osoja Energy” sh.p.k. te “Seman 1 Solar” sh.p.k.

- Subjekti “Seman 1 Solar” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 413/4 prot., datë 22.8.2018, ka shprehur dakordësinë e shoqërisë “Seman 1 Solar” sh.p.k. që pagesa e aplikimit për transferimin e licencës nga “Osoja Energy” sh.p.k. te “Seman 1 Solar” sh.p.k. të konsiderohet si pagesë e kryer nga shoqëria “Osoja Energy” sh.p.k.

- Subjekti “Osoja Energy” sh.p.k. ka marrë miratimin nga MIE me nr. 3245/1 prot., datë 20.4.2018, “Miratimi i transferimit të të drejtave”, për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve që disponon në respekt të miratimit përfundimtar nr. 3887/2 prot., 23.12.2017 dhe kontratës së lidhur me MIE-n, nr. 1163 rep. dhe nr. 376 kol., datë 29.12.2017, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik “Seman 1” me kapacitet instaluar 2 mw”, në zonën Sheq, Marinas, Topojë, Fier, në favor të shoqërisë “Seman 1 Solar” sh.p.k.

- Aplikimi i shoqërisë “Osoja Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Neni 8, pika 2,

Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin A të kësaj rregulloreje, në shumën 50 000 lekë: plotësuar.

- Neni 17, pika 1, kërkesë e të licencuarit për transferimin e plotë licencës: plotësuar.

- Neni 17, pika 4, germa “a”, “b”, “c” (në rastin e kërkesës nga i licencuari për transferimin e licencës jo sipas rastit të parashikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni):
 - germa “a”, formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1: plotësuar;
 - germa “b”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës: plotësuar;
 - germa “c”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës: plotësuar.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Osoja Energy” sh.p.k., me nr. 408, seria P18 K, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 14.5.2018, për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Seman 1”, me vendndodhje, Sheq, Marinas, Topojë, Bashkia Fier, me fuqi të instaluar 2 mw, për një afat 20-vjeçar, të shoqëria “Seman 1 Solar” sh.p.k.

2. Në titull dhe përmbajtje të licencës nr. 408, seria P18 K, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 14.5.2018, emërtimi “Osoja Energy” sh.p.k., do të zëvendësohet me emërtimin “Seman 1 Solar” sh.p.k.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti